

*Specialist në Sektorin e Përpunimit të të Dhënave 360°, në Drejtorinë e Përpunimit të të Dhënave Remote Sensing, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor*

Bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; në ligjin nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”; në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 20.02.2013 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, të ndryshuar; në Urdhrin e Kryeministrit nr. 04, datë 08.01.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor shpall konkurimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist në Sektorin e Përpunimit të të Dhënave 360°, në Drejtorinë e Përpunimit të të Dhënave Remote Sensing, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor**

#### **DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:**

- a) Të përpunojë dhe të analizojë informacionin gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet teknologjisë kamera 360°, të vëna në dispozicion nga institucione shtetërore si dhe të krijuara nga ASIG-u, në kuadër të projekteve të brendshme apo me bashkëpunim të huaj, bazuar në manualet apo praktikat më të mira në përputhje me standartet europiane.
- b) Të shpërndajë informacionin e përpunuar gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet teknologjisë kamera 360°, për autoritetet publike, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë.
- c) Të hartojë dhe të propozojë Draft/akte-nënligjore/manualë, në bashkëpunim me institucionet sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, për mënyrën e përdorimit të informacionit të përfutur nga monitorimi i territorit me teknologji të avancuar bazuar nga përvoja ndërkombetare dhe situata brenda vendit.
- d) Ndjek dhe realizon kontrollin e cilësisë të gjithë projekteve që lidhen me mbledhjen e informacionin gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet teknologjisë kamera 360°.
- e) Kujdeset për rritjen dhe ruajtjen e njohurive profesionale, të kuptuarit teknik dhe njohuritë praktike të punës, të metodologjive dhe përvetësimit të teknikave që lidhen me parimet dhe përdorimit të metodat e GIS dhe të Remote Sensing për të analizuar të dhënat gjeohapësinore dhe për të zgjidhur problemet për projektet që përfshijnë tematika të ndryshme.
- f) Përgjigjet për kryerjen dhe kontrollin e çdo punimi në mënyrë që produkti të jetë në përputhje me kërkesat teknike dhe saktësitë e miratuara në kuadrin ligjor në fuqi.
- g) Përgjigjet për referimin e çdo problematike të identifikuar gjatë procesit të punës dhe bën rekomandimet përkatëse.
- h) Menaxhon bazën e të dhënave të mbledhura nga përpunimi dhe analizimi i informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet përdorimit të teknologjisë kamera 360°, të

krijuar nga ASIG apo palët e treta dhe çdo produkt tjetër lidhur me fushën e veprimtarisë që mbulon sektori.

- i) Siguron përgatitjen e materialeve informuese për përgjegjësin e sektorit dhe, sipas rëndësisë dhe drejtorin e drejtorisë lidhur me realizimin e detyrave si dhe rast pas rasti për problematikat e hasura gjatë punës së tij.
- j) Kryen çdo funksion të ngarkuar nga eprori, për realizimin e veprimtarisë së sektorit dhe ASIG.
- k) Përdor infrastrukturën dhe teknologjinë përkatëse të përpunimit dhe të analizimit të informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet teknologjisë kamera 360°.
- l) Bën kontrollin e çdo informacioni gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet teknologjisë kamera 360° etj, të krijuara nga ASIG apo të marre nga autoritetet palë në këtë proces.
- m) Përfaqeson institucionin në takime pune dhe konferenca lidhur me fushën e veprimtarisë që mbulon sektori, sipas propozimit të drejtorit të drejtorisë dhe miratim të drejtorit të përgjithshëm.

## **KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT**

- 1. Të ketë mbaruar studimet e larta e të zotërojë diplomë “master profesional/shkencor”, diplomuar në Gjeodezi, Gjeoinformatikë, Gjeomatikë, Master profesional GIS.
- 2. Të ketë përvojë të paktën 1 (një) vit në profesion;
- 3. Të ketë njohuri të thelluara teorike dhe praktike lidhur me proceset e domosdoshme në përdorimin e teknologjive të avancuara (Remote Sensing).
- 4. Të ketë njohuri të legjislacionit shqiptar në fushën e informacionit gjeohapësinor.
- 5. Të ketë njohuri të thelluara në përdorimin e softuerit për analizimin e imazheve satelitore, ose Sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS) si: ArcGIS, QGIS, ERDAS, ENVI, etj. për të vlerësuar dhe analizuar të dhënat e marra nga sistemet Remote Sensing.
- 6. Të ketë njohuri të thelluara teorike lidhur me transformimin e informacionit gjeohapësinor nga një reference gjeodezike në një tjetër.
- 7. Të dokumentojë dhe zhvillojë rezultate si nga kërkimet shkencore dhe teknike bazë ashtu edhe ato të aplikuara për përdorim në raportet teknike dhe publikimet.
- 8. Njohuri të gjëra të fushës, të metodave kërkimore që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike, aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale, aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre.
- 9. Të ketë aftësi të mira komunikimi, propozimi dhe manaxhim projektesh si dhe aftësi të mira raportimi.
- 10. Të jetë njohës i mire i gjuhës angleze dhe njohja e gjuhëve të tjera është prioritet.

## **PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (IV-1)**

### **PARAQITJA E DOKUMENTEVE:**

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 15.03.2024, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II” Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë ose në adresën e e-mailit [burime.njerezore@asig.gov.al](mailto:burime.njerezore@asig.gov.al), këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV;
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave;
- Fotokopje të librezës së punës;
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja (nëse ka);
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi;
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar;

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.